



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teknika të Redaktimit dhe Shprehjes (lëndë në gjuhën shqipe)

Ngarkesa: 3 (tre) kredite; 30 orë (seminare)

Viti / Semestri: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master ‘‘Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim’’

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndorë:

Studenti duhet të ketë njohuri dhe praktikë shumë të mirë në fushën e përkthimit të tekstit të përkthyer në gjuhën A nga gjuha B; të analizës së tekstit, stilistikës gjuhësore. Gjithashtu duhet të zotërojë aftësi analitiko-sintetike, vlerësuese dhe vetëvlerësuese. Të stërviten studentët e ciklit të dytë në një nivel më të lartë krahasimi tekstesh të përkthyer e të botuara: së pari në vlerësimin e tyre objektiv nëpërmjet përjasjes kritike me tekstin origjinal dhe, së dyti, në vlerësimin e tyre subjektiv nëpërmjet motivimit serioz të zgjedhjes së tyre.

Objektivat specifikë lëndorë:

Studenti :

- 1.Njeh teknikat bazë të shkencës së përkthimit.
- 2.Përdor dhe shprehet me korrektësi në terminologjinë e fushës.
- 3.Komenton tekstet në kontekstin e tyre social, historik, juridik, letrar, etj.
- 4.Identifkon, familiarizohet, redakton textin e përkthyer.
- 5.Punon individualisht dhe në grup, debatojnë dhe marrin vendime sëbashku.
- 6.Vetëvlerësohet, fiton pavarësi si përkthyes.
- 7.Punon me fjalor.